

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

SHOQËRIA RAJONALE UJËSJELLËS KANALIZIME GJIROKASTËR SH.A

Nr. _____ Prot.

Gjirokastrë, më __.08.2026

PROCESVERBAL

PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE/TERMAVE TË REFERENCËS, KRITEREVE PËR KUALIFIKIM DHE KRITEREVE TË VLERËSIMIT

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

Objekti i procedurës	“Studim Projektim Ujësjellësi, për fshatrat e Bashkisë Memaliaj: Arrëz e Madhe, Maricaj, Vagalat, Tosk Martalloz, Dervishaj”
Lloji i kontratës	Shërbime
Lloji i procedurës	Procedurë e hapur, mbi kufirin e lartë monetar, shërbime
Fondi limit	19,209,148.44 (Nëntëmbëdhjetë milionë e dyqind e nëntë mijë e njëqind e dyzet e tetë lekë e dyzet e katër) lekë pa TVSH; 206,394.63 EUR, referuar kursit të B.SH datë 10.08.2026, 1 EUR = 93.07 ALL
Kodi FPP (CPV)	22114311-5 - Projekte
Burimi i financimit	AKUK

Baza ligjore dhe metodologjia e argumentimit: Ky procesverbal hartohet në zbatim të Ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, veçanërisht nenit 77; VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, veçanërisht neneve 41, 43, 44 dhe 78; Rekomandimit të APP nr. 3872 Prot., datë 10.06.2021 “Mbi hartimin e procesverbalit të argumentimit dhe miratimit të specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim”; si dhe Rekomandimit të APP nr. 787 Prot., datë 23.01.2026 “Mbi hartimin e kriterëve për kualifikim për procedurat e prokurimit për mallra, punë, shërbime”. Argumentimi teknik mbështetet në Detyrën e Projektimit të objektit dhe në kërkesën që çdo kriter të jetë i lidhur drejtpërdrejt dhe proporcional me natyrën, përmasat, kompleksitetin dhe afatin e kontratës.

Konteksti teknik i kontratës: Detyra e Projektimit parashikon studim-projektimin e një skeme të plotë furnizimi me ujë për pesë fshatra, në një zonë kodrinore-malore, ku një pjesë e rrjeteve ekzistuese janë të degraduara dhe të amortizuara, ndërsa në segmente ekzistojnë tubacione të vjetra. Projekti përfshin veprën e marrjes, linjat e transmetimit, depot, rrjetet shpërndarëse, pusetat e komandimit/reduktimit/ajrimit, matjen e konsumit, studime topografike, gjeologjike, hidrologjike e mjedisore, modelim dhe llogaritje hidraulike, projekt-ide dhe projekt zbatimi, si dhe preventivin përfundimtar. Sistemi projektohet për furnizim 24 orë/ditë dhe perspektivë 25-vjeçare.

2.13 Ndarja në Lote:**Po****Jo****X****ARGUMENTIMI**

Në mbështetje të nenit 39, pika 1, të Ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, si dhe nenit 42, pikat 1 dhe 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar, Autoriteti Kontraktor ka vlerësuar zhvillimin e procedurës së prokurimit pa ndarje në lote.

Objekti “Studim Projektim Ujësjellësi, për fshatrat e Bashkisë Memaliaj: Arrëz e Madhe, Maricaj, Vagalat, Tosk Martalloz, Dervishaj” përbën një shërbim të integruar dhe multidisiplinar projektimi, elementët e të cilit janë teknikisht dhe funksionalisht të ndërlidhur.

Studim-projektimi përfshin analizën e gjendjes ekzistuese, studimet topografike, gjeologjike, hidrologjike dhe hidrogjeologjike, përcaktimin e skemës së furnizimit me ujë, veprën e marrjes, linjat e transmetimit, depot, rrjetet shpërndarëse, pusetat, modelimin dhe llogaritjet hidraulike, si dhe hartimin e projektit të zbatimit dhe preventivit përfundimtar.

Ndarja e këtyre komponentëve në lote të veçanta do të krijonte ndërvarësi ndërmjet kontratave dhe operatorëve të ndryshëm, do të vështirësonte koordinimin teknik dhe unifikimin e parametrave të projektimit, modelimin e integruar hidraulik dhe përcaktimin e përgjegjësisë për produktin përfundimtar, si dhe mund të ndikonte në respektimin e afatit të realizimit të shërbimit.

Për këto arsye, duke marrë në konsideratë karakterin e integruar të studim-projektimit, ndërvarësinë teknike të komponentëve dhe nevojën për një produkt përfundimtar unik, të koordinuar dhe funksional, Autoriteti Kontraktor vlerëson se ndarja e kontratës në lote nuk është teknikisht dhe funksionalisht e përshtatshme.

4.4 Kriteret e përzgjedhjes së fituesit:

A) Oferta ekonomikisht më e favorshme, bazuar në kosto X

Sipas rëndësisë:

Cmimi x	pikët 50
Kualifikimet e Stafit Kryesor të Propozuar	pikët 20
Metodologjia e propozuar për kryerjen e shërbimit	pikët 20
Eksperiencia e ngjashme e kompanisë	pikët 10

Kriteri:

1. Çmimi [50 pikë]

Operatori ekonomik duhet të detajojë dhe përshkruajë ofertën e tij.

Pikët për këtë kriter përlogariten sipas formulës:

$$P_{k1} = V_{\min k1} \times P_{\max k1} / O_{k1}$$

P_{k1}	Pikët e kriterit që vlerësohet
V_{mink1}	Vlera e më e ulët e kriterit që vlerësohet
P_{maxk1}	Pikët maksimale që i jepen kriterit që vlerësohet
O_{k1}	Treguesi i ofertës për kriterin që vlerësohet

2. Kualifikimet e Stafit Kryesor të Propozuar [0- 20]

Numri i pikëve që do të vendoset për çdo pozicion apo specialitet duhet të përcaktohet duke marrë në konsideratë nënkriteret e mëposhtme dhe peshën përkatëse në përqindje:

- a- Kualifikim i përgjithshëm [5-20%]
- b- Eksperienca në fushën përkatëse [30-80 %]

- Kualifikimi i përgjithshëm përfshin: arsimimin përkatës dhe trajnimet, vitet e eksperiencës.
- Eksperienca në fushën përkatëse përfshin: eksperienca në sektorin specifik, fushën përkatëse, të lidhura këto me pozicionin e përcaktuar në stafin kryesor.

Në çdo rast, anëtarët e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave në mënyrë individuale duhet të argumentojnë dhe dokumentojnë lidhur me mënyrën e pikëzimit, sipas nënkritereve të mësipërme

3. *Stafi i kërkuar në pikën 2.3.4, nuk duhet të jetë i angazhuar në kontrata të tjera, apo të deklaruara në procedura të shpallura fituese.*

3. Metodologjia e Propozuar [0 – 20]

(Përqasja teknike dhe metodologjia, plani i punës, aftësia organizative)

Nënkriteret

- ii/a. Përqasja teknike dhe metodologjia [10-30%]
- ii.b Plan i punës dhe grafiku i dorëzimit të projektit [30-40%]
- ii.c. Organizimi i Stafit [10-30%]

ii/a. Përqasja teknike dhe metodologjia: Konsulenti duhet të shpjegojë që i ka kuptuar objektivat e detyrës së dhënë në Termat e Referencës, përqasjen teknike, metodologjinë për të realizuar aktivitetet e ndryshme, duke përfutur rezultatet e pritura dhe shkallën e detajimit të këtyre rezultateve. Konsulenti duhet të paraqesë problemet kryesore dhe rëndësinë e tyre dhe të shpjegojë përqasjen teknike që do të adaptojnë për zgjidhjen e tyre. Konsulenti duhet të shpjegojë metodologjinë që propozon të adoptojë dhe të paraqesë kompatibilitetin e këtyre metodologjive me përqasjen e propozuar (konsulenti në këtë rast nuk duhet të përsërisë/kopjojë Termat e Referencës).

ii/b. Plan i Punës dhe grafiku i dorëzimit të projektit: Konsulenti duhet të propozojë aktivitetet kryesore të detyrës, përmbajtjen dhe kohëzgjatjen e dorëzimit të projektit, fazat dhe ndërlidhjen midis tyre, etapat e dorëzimit të raporteve dhe projektit. Plan i propozuar i punës duhet të përputhet me përqasjen teknike dhe metodologjinë, duke treguar se i ka kuptuar kërkesat e Termat e Referencës në plan pune konkret. Gjithashtu, duhet të tregojë aftësinë për t'i transformuar kërkesat e Termave të Referencës në plan pune

konkret. Një listë e dokumentave përfundimtare përfshirë raportet, vizatimet dhe tabelat të cilat duhen dorëzuar, duhet përfshirë në këtë kapitull.

ii/c. Organizimi dhe Stafit: Konsulenti duhet të përshkruajë kompozimin dhe strukturën e skuadrës së tij, listën e ekspertëve kryesore, stafin mbështetës, CV e firmës dhe personelin ekonomiko-administrativ.

Në çdo rast, anëtarët e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave në mënyrë individuale duhet të argumentojnë dhe dokumentojnë lidhur me mënyrën e pikëzimit sipas nënkritereve të mësipërme.

4. Eksperienca e ngjashme e kompanisë Pikët 10

Operatorët ekonomikë do të vlerësohen bazuar në eksperiencat e ngjashme që kanë lidhur me objektin prokurimit.

Pikët për këtë nën-kriter përllogariten sipas formulës:

Pikët për këtë nën-kriter përllogariten sipas formulës:

$$P_{k5} = V_{\min k5} \times P_{\max k5} / O_{k5}$$

P_{k5}	Pikët e kriterit që vlerësohet
$V_{\min k5}$	Vlera e më e ulët e kriterit që vlerësohet
$P_{\max k5}$	Pikët maksimale që i jepen kriterit që vlerësohet
O_{k5}	Treguesi i ofertës për kriterin që vlerësohet

Formula me të cilën llogariten pikët e ofertuesve, në çdo rast duhet të jetë:

$$P_o = P_{k1} + P_{k2} + P_{k3}$$

ARGUMENTIMI I KRITEREVE TË PËRZGJEDHJES SË FITUESIT

4.4 Kriteret e përzgjedhjes së fituesit:

A) Oferta ekonomikisht më e favorshme, bazuar në kosto

Për përcaktimin e ofertës ekonomikisht më të favorshme, Autoriteti Kontraktor ka përcaktuar kombinimin e elementit ekonomik me elementët teknikë dhe profesionalë të ofertës, duke marrë në konsideratë natyrën specifike të objektit **“Studim Projektim Ujësjellësi, për fshatrat e Bashkisë Memaliaj: Arrëz e Madhe, Maricaj, Vagalat, Tosk Martalloz, Dervishaj”**.

Objekti i prokurimit përbën një shërbim me natyrë intelektuale dhe multidisiplinare, ku cilësia e produktit përfundimtar lidhet drejtpërdrejt me aftësinë profesionale të stafit, metodologjinë e propozuar dhe eksperiencën e operatorit ekonomik. Detyra e Projektimit parashikon realizimin e analizës së gjendjes ekzistuese, projekt-idesë paraprake dhe përfundimtare, projektit të zbatimit, llogaritjeve hidraulike e konstruktive, studimeve topografike, hidrologjike dhe gjeologjike, specifikimeve teknike dhe preventivit përfundimtar.

Për këtë arsye është përcaktuar vlerësimi sipas rëndësisë:

Çmimi - 50 pikë

Kualifikimet e Stafit Kryesor të Propozuar - 20 pikë

Metodologjia e propozuar për kryerjen e shërbimit - 20 pikë

Eksperienca e ngjashme e kompanisë - 10 pikë

1. Çmimi [50 pikë]

Argumentimi:

Kriteri i çmimit është përcaktuar me **50 pikë**, duke i dhënë ofertës ekonomike një peshë të rëndësishme në vlerësimin përfundimtar dhe duke garantuar përdorimin ekonomik dhe efikas të fondeve publike.

Përcaktimi i këtij kriteri synon të krijojë konkurrencë reale ndërmjet operatorëve ekonomikë edhe në aspektin financiar, duke mundësuar krahasimin objektiv të ofertave të paraqitura për të njëjtin shërbim dhe të njëjtat kërkesa teknike.

Operatori ekonomik duhet të detajojë dhe përshkruajë ofertën e tij, ndërsa pikët do të përlllogariten sipas formulës së përcaktuar në DST:

$$Pk1 = Vmink1 \times Pmaxk1 / Ok1$$

ku:

Pk1 - Pikët e kriterit që vlerësohet;

Vmink1 - Vlera më e ulët e kriterit që vlerësohet;

Pmaxk1 - Pikët maksimale që i jepen kriterit që vlerësohet;

Ok1 - Treguesi i ofertës për kriterin që vlerësohet.

Përdorimi i formulës siguron një mënyrë të njëjtë dhe të matshme të përlllogaritjes së pikëve për të gjithë ofertuesit, në varësi të vlerës ekonomike të ofertës së paraqitur.

2. Kualifikimet e Stafit Kryesor të Propozuar [0-20]

Argumentimi:

Kriteri **“Kualifikimet e Stafit Kryesor të Propozuar”** është përcaktuar me deri në **20 pikë**, pasi cilësia e një shërbimi studim-projektimi varet në mënyrë të drejtpërdrejtë nga aftësitë, kualifikimi dhe eksperienca profesionale e ekspertëve që do të angazhohen në hartimin e projektit.

Objekti kërkon bashkërendimin e disa disiplinave inxhinierike. Në pikën 2.3.4 të DST-së është kërkuar staf që përfshin inxhinierë ndërtimi, gjeodetë/markshajderë, inxhinier gjeolog, elektrik, mekanik dhe hidroteknik, çka lidhet me kompleksitetin dhe ndërthurjen e disiplinave që kërkon projekti.

Për këtë arsye, vlerësimi i stafit kryesor do të marrë në konsideratë:

a) Kualifikimin e përgjithshëm [5-20%], ku përfshihet arsimimi përkatës, trajnimet dhe vitet e eksperiencës. Ky element synon të vlerësojë formimin profesional dhe nivelin e përgjithshëm të ekspertizës së specialistëve të propozuar.

b) Eksperiencën në fushën përkatëse [30-80%], ku merret në konsideratë eksperiencia në sektorin specifik dhe në fushën përkatëse të lidhur me pozicionin e secilit ekspert në realizimin e projektit.

Peshë më e rëndësishme i jepet eksperiencës së lidhur me fushën, pasi për realizimin e një studim-projektimi të ujësjellësit është e rëndësishme që ekspertët të kenë jo vetëm formim akademik, por edhe përvojë konkrete në problematika dhe projekte të ngjashme.

Anëtarët e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave do të argumentojnë dhe dokumentojnë individualisht mënyrën e pikëzimit, sipas nënkritereve të përcaktuara në Dokumentet e Tenderit.

3. Stafi i kërkuar në pikën 2.3.4 nuk duhet të jetë i angazhuar në kontrata të tjera, apo të deklaruar në procedura të shpallura fituese

Argumentimi:

Kjo kërkesë është vendosur për të garantuar **disponueshmërinë faktike dhe efektive të stafit kryesor** të propozuar për realizimin e shërbimit.

Referuar Detyrës së Projektimit, projekti përfshin disa faza të ndërlidhura dhe intensive, duke filluar nga analiza dhe vërtetimet në terren, deri në projekt-idenë, projektin e zbatimit dhe preventivin përfundimtar. Afati për realizimin e produktit është i kufizuar, çka kërkon angazhim të vazhdueshëm dhe koordinim të stafit profesional.

Angazhimi paralel i të njëjtit staf kryesor në kontrata të tjera mund të ndikojë në disponibilitetin real të specialistëve, koordinimin ndërdisiplinor, respektimin e afateve dhe cilësinë e produktit përfundimtar. Për këtë arsye, kërkesa është e lidhur drejtpërdrejt me nevojën e Autoritetit/Entit Kontraktor për të garantuar që ekspertët e deklaruar në ofertë të jenë realisht të disponueshëm gjatë realizimit të kontratës.

4. Metodologjia e Propozuar [0-20]

Argumentimi:

Kriteri **“Metodologjia e Propozuar”** është përcaktuar me deri në **20 pikë**, pasi mënyra se si operatori ekonomik koncepton, organizon dhe propozon realizimin e shërbimit është një element thelbësor për cilësinë e studim-projektimit.

Detyra e Projektimit nuk kërkon vetëm përgatitjen e vizatimeve teknike, por realizimin e një procesi të plotë studimor dhe projektues, që përfshin analizën e gjendjes ekzistuese, rilevimet, studimet përkatëse, llogaritjet hidraulike, analizimin e varianteve, projektimin e veprës së marrjes, linjave të transmetimit, depove dhe rrjeteve shpërndarëse, si dhe hartimin e dokumentacionit përfundimtar.

Për këtë arsye, kriteri ndahet në nënkriteret e përcaktuara në DST:

ii/a. Përqasja teknike dhe metodologjia [10-30%]

Ky nënkriter është vendosur për të vlerësuar nivelin e kuptimit të objektivave të Detyrës së Projektimit dhe mënyrën konkrete që operatori ekonomik propozon për realizimin e tyre.

Do të vlerësohet aftësia e konsulentit për të evidentuar problematikat kryesore, për të propozuar mënyrën e trajtimit të tyre dhe për të paraqitur një metodologji të përshtatshme për realizimin e studimeve, analizave, llogaritjeve dhe projektimit.

Kërkesa që konsulenti të mos përsërisë apo kopjojë Termat e Referencës synon të evidentojë aftësinë reale të tij për të kuptuar objektin dhe për të paraqitur një qasje konkrete profesionale.

ii/b. Plani i punës dhe grafiku i dorëzimit të projektit [30-40%]

Ky nënkriter është vendosur për të vlerësuar aftësinë e operatorit ekonomik për të organizuar në mënyrë logjike dhe realiste të gjitha aktivitetet e nevojshme për realizimin e shërbimit.

Detyra e Projektimit parashikon faza të përcaktuara dhe të ndërlidhura të punës, prandaj është e nevojshme që operatori ekonomik të demonstrojë mënyrën se si do të organizojë aktivitetet, afatet, etapat e dorëzimit, raportet, vizatimet dhe produktet përfundimtare.

Plani i punës duhet të jetë në përputhje me metodologjinë e propozuar dhe me afatin e realizimit të kontratës, duke mundësuar kontrollin e ecurisë dhe respektimin e afateve.

ii/c. Organizimi dhe Stafi [10-30%]

Ky nënkriter synon të vlerësojë mënyrën e organizimit të ekipit që do të realizojë shërbimin, strukturën e skuadrës, shpërndarjen e detyrave dhe koordinimin ndërmjet ekspertëve kryesorë dhe stafit mbështetës.

Natyra multidisiplinare e projektit kërkon bashkëpunim të vazhdueshëm ndërmjet specialistëve të hidroteknikës, ndërtimit, gjeodezisë, gjeologjisë, elektrikës, mekanikës dhe disiplinave të tjera të përfshira. Për rrjedhojë, mënyra e organizimit të stafit ka ndikim të drejtpërdrejtë në cilësinë, koherencën dhe realizimin në kohë të projektit.

Në çdo rast, anëtarët e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave do të argumentojnë dhe dokumentojnë individualisht mënyrën e pikëzimit sipas nënkritereve të mësipërme.

4. Eksperienca e ngjashme e kompanisë – Pikët 10

Argumentimi:

Kriteri “**Eksperienca e ngjashme e kompanisë**” është përcaktuar me **10 pikë**, me qëllim vlerësimin e përvojës së operatorit ekonomik në realizimin e suksesshëm të kontratave të ngjashme me objektin e prokurimit.

Studim-projektimi i një sistemi ujësjellësi kërkon eksperiencë praktike në studimin dhe projektimin e veprave të furnizimit me ujë, analizën e skemave hidraulike, linjave të transmetimit, rezervuarëve, rrjeteve shpërndarëse dhe veprave të tjera të lidhura me to.

Eksperienca e mëparshme në kontrata të ngjashme krijon një tregues të aftësisë së operatorit ekonomik për të menaxhuar problematika të krahasueshme teknike, për të koordinuar specialitetet e nevojshme dhe për të realizuar me sukses produktin e kërkuar.

Pesha prej **10 pikësh** është përcaktuar duke marrë në konsideratë se eksperiencia e kompanisë është një element i rëndësishëm i cilësisë së ofertës, krahas kualifikimit të stafit, metodologjisë së propozuar dhe ofertës ekonomike.

Operatorët ekonomikë do të vlerësohen bazuar në eksperiencat e ngjashme që kanë lidhje me objektin e prokurimit dhe pikët do të përlogariten sipas formulës së përcaktuar në DST:

$$Pk5 = Vmink5 \times Pmaxk5 / Ok5$$

ku:

Pk5 - Pikët e kriterit që vlerësohet;

Vmink5 - Vlera më e ulët e kriterit që vlerësohet;

Pmaxk5 - Pikët maksimale që i jepen kriterit që vlerësohet;

Ok5 - Treguesi i ofertës për kriterin që vlerësohet.

Përlllogaritja përfundimtare e pikëve do të bëhet sipas formulës së përcaktuar në Dokumentet e Tenderit:

$$Po = Pk1 + Pk2 + Pk3$$

Në përfundim, kriteret e mësipërme janë përcaktuar duke marrë në konsideratë objektin, natyrën dhe kompleksitetin e shërbimit të kërkuar, me qëllim që vlerësimi të marrë në konsideratë njëkohësisht **koston e ofertës, kualifikimin dhe eksperiencën e stafit, cilësinë e metodologjisë së propozuar dhe eksperiencën e operatorit ekonomik**, elementë që ndikojnë drejtpërdrejt në realizimin me cilësi të Studim-Projektimit.

BAZA LIGJORE

- **Ligji nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar me Ligjin nr. 16/2024**, veçanërisht neni 87 “**Kriteret për shpalljen e ofertës fituese**”, lidhur me përcaktimin e ofertës ekonomike më të favorshme, raportin çmim-cilësi, cilësinë dhe meritat teknike, organizimin, kualifikimin dhe përvojën e stafit, lidhjen e kriterëve me objektin e kontratës, konkurrencën efektive dhe përcaktimin e peshës relative të çdo kriteri.
- **VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, e ndryshuar, neni 2, pika 2, shkronja “c”**, për detyrimin e autoritetit/entit kontraktor për dokumentimin dhe argumentimin e kriterëve të përcaktuara në procedurën e prokurimit.
- **VKM nr. 285, datë 19.05.2021, e ndryshuar, neni 41 “Kërkesa të veçanta për kontratat e shërbimeve”**, veçanërisht pikat 1, 2, 3 dhe 4, lidhur me termat e referencës, proporcionalitetin e kërkesave, përvojën e mëparshme për shërbime të ngjashme, personelin kryesor dhe, për shërbimet me natyrë intelektuale, eksperiencën sipas fushave përkatëse të ekspertizës dhe deklaratën e disponueshmërisë së stafit.
- **VKM nr. 285, datë 19.05.2021, e ndryshuar, neni 45 “Kriteret për shpalljen e ofertës fituese”**, veçanërisht pikat 1, 2, 4, 5, 6, 7 dhe 8, lidhur me ofertën ekonomike më të favorshme, kriteret e cilësisë, organizimin, kualifikimin dhe përvojën e stafit, lidhjen e kriterëve me objektin e kontratës, konkurrencën efektive, përcaktimin e peshës së kriterëve dhe mënyrën e përlllogaritjes së pikëve.
- **VKM nr. 285, datë 19.05.2021, e ndryshuar, neni 45, pika 9**, për kontratat e shërbimeve me natyrë intelektuale ku nuk mbizotërojnë aspektet fizike dhe kërkohet ekspertizë e posaçme; kjo dispozitë përcakton si kriterë të propozimit teknik: **përvojën për punë të ngjashme të**

konsulentit, cilësinë e metodologjisë së propozuar dhe kualifikimet e stafit kryesor të propozuar, si dhe formulën e vlerësimit të propozimit ekonomik.

- **Dokumentet Standarde të Tenderit për procedurën e prokurimit “E hapur” – Shërbime**, të miratuara me **Vendimin e APP-së nr. 10, datë 23.09.2024**, në pjesën “Kriteret e përcaktimit të ofertës fituese”.

1. KRITERET E PËRGJITHSHME TË PËRZGJEDHJES/ KUALIFIKIMIT

Ofertuesi deklaron se:

- a) është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin, ose sipas legjislacionit të posaçëm në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv;
- b) nuk është në proces falimentimi (status aktiv);
- c) nuk është dënuar për ndonjë vepër penale, në përputhje me nenin 76/1 të LPP-së;
- ç) personi (personat) që veprojnë si anëtar i organit administrativ, drejtori ose mbikëqyrësi, aksioneri ose ortak, ose që ka fuqi përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda Operatorit Ekonomik, nuk është i dënuar ose nuk ka qenë i dënuar nga një vendim i gjykatës i formës së prerë për çdo vepër penale, të përcaktuar në nenin 76/1 të LPP-së;
- d) nuk është shpallur fajtor për shkelje të rëndë profesionale, për sa kohë që nuk është parashkruar, sipas legjislacionit në fuqi;
- dh) nuk ka pagesa të pashlyera të taksave dhe kontributeve të sigurimeve shoqërore, ose ndodhet në një prej kushteve të parashikuara në nenin 76/2 të LPP-së;
- e) ka paguar energjinë elektrike dhe plotëson kërkesat që burojnë nga legjislacioni në fuqi. Ky informacion kërkohet për Operatorët Ekonomikë, të cilët operojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë.
- f) nuk është në kushtet e konfliktit të interesit, sipas legjislacionit në fuqi;
- g) ushtron veprimtarinë në përputhje me legjislacionin përkatës mjedisor, social dhe të punës;
- gj) ka paraqitur një Ofertë të Pavarur, sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi;
- h) kryen aktivitetin në përputhje me kërkesat e legjislacionit në fuqi.
- i) nuk ka në cilësinë e anëtarit të organit të administrimit, drejtues ose mbikëqyrës i atij, aksionar ose ortak, ose me kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda tij persona të cilët janë/kanë qenë në këtë cilësi në një operator ekonomik të përjashtuar nga e drejta për të fituar kontrata publike, me vendim të Agjencisë së Prokurimit Publik, gjatë kohës që ky vendim është në fuqi.

j) ka regjistruar pronarët përfitues në regjistrin e pronarëve përfitues, sipas parashikimeve të legjislacionit në fuqi;

k) zbaton detyrimet që rrjedhin nga legjislacioni në fuqi për pagat bazë referuese për kategori profesioni për punonjësit e pajtuar në punë. Ky informacion kërkohet për Operatorët Ekonomikë, i regjistruar në regjistrin tregtar shqiptar.

Këto kritere duhet të përmbushen me paraqitjen e Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit të operatorit ekonomik në ditën e hapjes së Ofertës, sipas Shtojcës 10.

Në rast bashkimi të operatorëve ekonomikë, secili anëtar i grupit duhet të paraqesë Vetëdeklarimin e lartpërmendur.

Në rast se, operatori ekonomik ofertues do të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, Vetëdeklarimi i lartpërmendur duhet të paraqitet edhe nga subjekti mbështetës.

Kriteret e Përgjithshme të Pranimit nuk duhet të ndryshohen nga Autoritetet/Entet Kontraktore.

Në çdo rast, Autoriteti/EntiKontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme për vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga Operatori Ekonomik, për sa më sipër.

➤ Nëse oferta paraqitet nga një bashkim Operatorësh Ekonomikë, do të paraqitet :

Marrëveshje bashkëpunimi ndërmjet Operatorëve Ekonomikë, ku caktohet përfaqësuesi, përqindja e pjesëmarrjes në bashkim, dhe elementët që merr përsipër të realizojë secili prej anëtarëve të bashkimit.

➤ Nëse, një operator ekonomik dëshiron të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, ai i vërteton autoritetit ose entit kontraktor se do të ketë në dispozicion burimet e nevojshme, duke dorëzuar një angazhim me shkrim të këtyre subjekteve për këtë qëllim.

Baza ligjore:

Neni 76 dhe neni 77 i Ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar; VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, e ndryshuar; si dhe Dokumentet Standarde të Tenderit për procedurën e hapur – Shërbime, të miratuara nga Agjencia e Prokurimit Publik. Kriteret detyruese për skualifikim parashikohen nga neni 76 i LPP-së, ndërsa kërkesat për kualifikim dhe aftësitë e operatorëve ekonomikë lidhen me nenin 77.

Argumentimi:

Kriteret e Përgjithshme të Përzgjedhjes/Kualifikimit janë kritere standarde dhe të detyrueshme, të përcaktuara në Dokumentet Standarde të Tenderit dhe synojnë verifikimin e përshtatshmërisë ligjore të operatorëve ekonomikë për pjesëmarrjen në procedurën e prokurimit. Nëpërmjet tyre verifikohet që operatori ekonomik ushtron aktivitet të ligjshëm, nuk ndodhet në kushtet e përjashtimit të parashikuara nga legjislacioni i prokurimit publik dhe përmbush detyrimet ligjore, tatimore, sociale dhe profesionale. Përmbushja e tyre deklarohet nëpërmjet Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit. Në DST-në e kësaj procedure është përcaktuar shprehimisht se këto kritere **nuk duhet të ndryshohen nga Autoriteti/Enti Kontraktor.**

Për pjesën e **Bashkimit të Operatorëve Ekonomikë dhe mbështetjes në kapacitetet e subjekteve të tjera**, baza ligjore plotësohet edhe me **nenin 84 të Ligjit nr. 162/2020, i ndryshuar, dhe nenin 90 të VKM nr. 285/2021, e ndryshuar**, lidhur me të drejtën e operatorit ekonomik për t'u mbështetur në kapacitetet e subjekteve të tjera dhe detyrimin për të provuar se burimet përkatëse do të jenë realisht në dispozicion.

I. ARGUMENTIMI I KRITEREVE TË VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

- a. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas Shtojcës 10.
- b. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;

Mbështetja ligjore: Ligji nr. 162/2020, i ndryshuar; VKM nr. 285/2021, e ndryshuar; Dokumentet Standarde të Tenderit për shërbime mbi kufirin e lartë monetar.

Argumentimi: Këto dokumente janë pjesë e formularëve standardë të procedurës dhe shërbejnë respektivisht për provën paraprake të përmbushjes së kushteve të kualifikimit dhe për garantimin e seriozitetit të ofertës. Vlera dhe forma e sigurimit të ofertës përcaktohen në Dokumentet e Tenderit në përputhje me legjislacionin e prokurimit publik.

2.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:

Argumentimi: Në DST-në e paraqitur nuk është vendosur një kriter i veçantë shtesë në këtë nënseksion; për rrjedhojë, nuk ka kërkesë të posaçme për t'u argumentuar përtej kriterëve të përgjithshme dhe licencave profesionale të përcaktuara të kapaciteti teknik.

2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1

2.2.1 Kopje të deklarimit të xhiros vjetore gjatë 3 (tre) viteve të fundit financiare (2023, 2024, 2025) lëshuar nga Autoriteti përkatës, ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 40% e vlerës së përlogaritur të kontratës.

(Kjo kërkesë do të konsiderohet e përmbushur nëse Operatori ekonomik arrin vlerën e xhiros minimale në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga Autoriteti Kontraktor).

Mbështetja ligjore: Neni 77 i Ligjit nr. 162/2020, i ndryshuar; neni 43, pikat 1, 2, 3 dhe 6, të VKM nr. 285/2021, të ndryshuar.

Argumentimi: Kërkesa synon të verifikojë që operatori ekonomik ka një kapacitet minimal financiar për të përballuar organizimin dhe realizimin e një shërbimi projektimi multidisiplinar me afat të shkurtër. Për kontratat e shërbimeve me natyrë intelektuale, kërkesa prej 40% është në kufirin e parashikuar nga rregullat e prokurimit. Për fondin limit 19,209,148.44 lekë pa TVSH, 40% është 7,683,659.38 lekë. Kërkesa është vendosur që të mjaftojë arritja e kësaj vlere në të paktën një nga tre vitet, duke ruajtur proporcionalitetin dhe duke mos kufizuar pa nevojë konkurrencën.

2.2.2

2.2.2 Për të vërtetuar një aktivitet pozitiv të qëndrueshëm Operatori ekonomik duhet të paraqesë Kopje të çertifikuara të bilanceve të 3 (tre) viteve të fundit financiare (2023, 2024, 2025) të paraqitur në Autoritetet përkatëse Dega e Tatim Taksave të konfirmuara nga ky Autoritet si dhe të shoqëruara me Akt Ekspertizën e Ekspertit Kontabël të Autorizuar, në rastin kur janë në kushtet e përcaktimeve në

përputhje me Ligjin Nr.10091, datë 05.03.2009 "Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabël të regjistruar dhe të kontabilistit të miratuar", (i ndryshuar).

Mbështetja ligjore: Neni 77 i Ligjit nr. 162/2020, i ndryshuar; neni 43, pikat 4 dhe 6, të VKM nr. 285/2021, të ndryshuar; legjislacioni në fuqi për auditimin ligjor.

Argumentimi: Kërkesa për bilancet e tre viteve të fundit synon të verifikojë që operatori ka një strukturë financiare të qëndrueshme dhe kapacitet për të përballuar shpenzimet e personelit, pajisjeve, punës në terren dhe përpunimit teknik deri në dorëzimin e produktit. Periudha trevjeçare është periudha maksimale e lejuar për këtë informacion. Akt-ekspertiza kërkohet vetëm kur operatori ndodhet në kushtet ligjore të auditimit, ndaj nuk krijon një detyrim shtesë për subjektet që nuk i nënshtrohen auditimit ligjor. Vlerësimi i të dhënave financiare do të bëhet sipas standardit të nenit 43 të rregullave të prokurimit.

2.2.3

2.2.3 Operatori ekonomik ofertues duhet të mos ketë detyrime për taksat vendore për vitin 2025 (ku të përfshihet kësti për periudhën përkatëse të maturuar sipas Ligjit Nr. 9632 datë 30.10.2006 "Për sistemin e taksave vendore", i ndryshuar), duke paraqitur një vërtetim nga organet e qeverisjes vendore ku ushtron aktivitetin. Në rast bashkimi operatorësh ekonomikë, vërtetimin nga organet e qeverisjes vendore duhet ta ketë secili subjekt më vete.

Mbështetja ligjore: Ligji nr. 9632, datë 30.10.2006 "Për sistemin e taksave vendore", i ndryshuar; neni 77 i Ligjit nr. 162/2020, i ndryshuar.

Argumentimi: Kërkesa synon verifikimin e përmbushjes së detyrimeve fiskale vendore nga operatori ekonomik në vendin ku ushtron aktivitetin dhe lidhet me besueshmërinë juridike e financiare të ofertuesit. Në rast bashkimi operatorësh, detyrimi është individual për secilin anëtar, pasi detyrimet vendore lidhen me secilin subjekt juridik më vete.

2.3 Kapaciteti teknik:

2.3.1

Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për shërbimet e mëparshme, të ngjashme me objektin e prokurimit, të realizuara gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, me një vlerë jo më të vogël se 40% e vlerës së përllogaritur të objektit që prokurohet.

a) Kur shërbimet e ngjashme janë realizuar me ente publike, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetimin e lëshuar nga enti publik për përmbushjen me sukses të kontratës, dhe/ose faturat tatimore të shitjes të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruara në organet tatimore, ku të shënohen datat, shumat dhe sasitë e shërbimeve të realizuara.

b) Kur shërbimet e ngjashme janë realizuar me subjekte private, operatori ekonomik duhet të paraqesë faturën përkatëse tatimore të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruara në organet tatimore, ku të shënohen datat, shumat dhe sasitë e shërbimeve të realizuara.

Mbështetja ligjore: Neni 77 i Ligjit nr. 162/2020, i ndryshuar; neni 41, pika 3, i VKM nr. 285/2021, të ndryshuar.

Argumentimi: Përvoja e ngjashme është e nevojshme për të provuar se operatori ka realizuar me sukses shërbime projektimi të një natyre dhe kompleksiteti të krahasueshëm, ku kërkohet koordinim multidisiplinar, punë në terren, llogaritje hidraulike, projektim infrastrukture dhe dokumentacion zbatimi. Vlera 40% e fondit limit, është kufiri maksimal i lejuar për shërbimet në këtë kategori dhe konsiderohet proporcional me rëndësinë e projektit, i cili shërben si bazë për një investim të

konsiderueshëm në sistemin e furnizimit me ujë. Dokumentet provuese për kontratat publike dhe private janë përcaktuar në formën e parashikuar nga rregullat e prokurimit.

2.3.2

Operatori ekonomik duhet të disponojë licencë projektimi sipas rregullores së miratuar me VKM nr. 943, datë 28/12/2016 “Për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale për individë dhe persona juridikë në fushën e studimit e të projektimit në ndërtim dhe mbikëqyrje e kolaudimit të punimeve të zbatimit në ndërtim”.

Licenca e projektimit duhet të ketë kategoritë si më poshtë:

- 3.c2 Troje dhe shpate me qendrueshmeri te ulet
- 5.b Projektim furnizim me uje / kolektore shkarkimi
- 5.c Projektim ujesjelles-kanalizime
- 8.a Rivelime inxhinierike.
- 8.d Bazamente gjeodezike
- 8.e Projektim fotogrametrik dhe hartografik
- 9.e Studime e Projektme hidrogeologjike

(Për Operatorët e huaj të bëhet njehsimi i licencës profesionale që disponojnë nga vendi i origjinës pranë institucionit përkatës, në plotësim të licencave profesionale të kërkuara për ekzekutimin e kontratës).

Sqarim: Për licencat e lëshuara pas hyrjes në fuqi të Vendimit nr.943, datë 28.12.2016 “Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr.759, datë 12.11.2014, të Këshillit të Ministrave ‘Për licencimin profesional të individëve dhe personave juridike që do të ushtrojnë veprimtari në fushën e studimit e projektimit në ndërtim dhe mbikëqyrjes e kolaudimit të punimeve të zbatimit në ndërtim”, Operatori ekonomik pjesëmarrës duhet të paraqesë Liçensa profesionale të shoqërisë (e vlefshme) për projektim (lëshuar nga MZHUT ose institucione të tjera të autorizuar sipas legjislacionit në fuqi për dhënien e liçensave profesionale në fushën e studim projektimit në ndërtim), e vlefshme, ku të përfshihen kategoritë e mësipërme me ndryshimet përkatëse në emërtesë.

Mbështetja ligjore: Neni 41, pika 4, i VKM nr. 285/2021, të ndryshuar; VKM nr. 759, datë 12.11.2014, e ndryshuar me VKM nr. 943, datë 28.12.2016; Rekomandimi APP nr. 787/2026.

Argumentimi: Kategoritë e licencës janë lidhur me komponentët konkretë të Detyrës së Projektimit: 5.b dhe 5.c lidhen drejtpërdrejt me projektimin e furnizimit me ujë, linjave të transmetimit, depove dhe rrjeteve shpërndarëse; 8.a dhe 8.d lidhen me rlevimin topografik, pikat e kontrollit dhe bazën gjeodezike; 8.e lidhet me hartografimin, studimet morfologjike tokësore/ajrore dhe modelin dixhital të terrenit; 9.e lidhet me vlerësimin e burimeve dhe studimet hidrogeologjike; 3.c2 lidhet me verifikimin e kushteve të terrenit, stabilitetit dhe raportin gjeologjik për veprën e marrjes, rezervuarët, pusetat dhe trasetë e tubacioneve në terren kodrinor-malor. Për këtë arsye kategoritë janë funksionale ndaj produktit që kërkohet dhe jo kërkesa të shkëputura nga objekti.

2.3.3

Një punësim mesatar i të paktën 16 (gjashtembedhjete) personave, të cilët duhet të figurojnë në listpagesat e shoqërisë minimumi për 3 muajt e fundit te deklaruar nga data e hapjes se ofertave vërtetuar me:

- a. Vërtetim të lëshuar nga Administrata Tatimore minimumi për 3 muajt e fundit te deklaruar nga data e hapjes se ofertave.
- b. Listpagesat e punonjesve te konfirmuara nga autoritetet perkatese sipas formatit qe kerkohet nga legjislacioni ne fuqi minimumi për 3 muajt e fundit te deklaruar.

Shënim: Kjo kërkesë do të konsiderohet e përmbushur nëpërmjet plotësimit dhe paraqitjes nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës 10 të DST.

Dokumentacioni provues do të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar në vend të parë, pranë autoritetit kontraktor, përpara publikimit të njoftimit të fituesit paraprak dhe nisjes së afateve të ankimit.

Mbështetja ligjore: Neni 41, pika 4, i VKM nr. 285/2021, të ndryshuar; Rekomandimi APP nr. 787/2026.

Argumentimi: Kërkesa që operatori ekonomik të ketë një punësim mesatar prej të paktën **16 (gjashtëmbëdhjetë) personash**, për minimumi 3 muajt e fundit të deklaruar nga data e hapjes së ofertave, është përcaktuar në raport me **natyrën, volumin dhe kompleksitetin teknik të shërbimit** objekt prokurimi.

Objekti përfshin studim-projektimin e sistemit të furnizimit me ujë për **pesë fshatra të Bashkisë Memaliaj**, duke kërkuar realizimin e një sërë aktiviteteve të ndërlidhura, si rievime dhe matje topografike, studime gjeologjike e hidroteknike, analiza dhe llogaritje hidraulike, projektimin e veprave të marrjes, linjave të transmetimit, depove, rrjeteve shpërndarëse, veprave të komandimit dhe kontrollit, si dhe hartimin e dokumentacionit teknik, grafik dhe ekonomik të projektit.

Numri minimal prej **16 punonjësish** është përcaktuar duke marrë në konsideratë edhe strukturën e personelit të kërkuar në DST për realizimin e kontratës. Vetëm stafi kryesor inxhinierik i kërkuar përfshin **2 inxhinierë ndërtimi, 2 inxhinierë gjeodetë/markshajderë, 1 inxhinier gjeolog, 1 inxhinier elektrik, 1 inxhinier mekanik dhe 2 inxhinierë hidroteknikë**, pra një strukturë prej 9 specialistësh kryesorë. Krahas tyre, DST kërkon edhe staf mbështetës dhe personel me kualifikime/certifikime specifike për realizimin e shërbimit.

Për këtë arsye, kërkesa për të paktën **16 punonjës** synon të vërtetojë se operatori ekonomik disponon një **kapacitet real, të qëndrueshëm dhe të mjaftueshëm organizativ e njerëzor**, jo vetëm personelin minimal teknik, por edhe burimet njerëzore të nevojshme për mbështetjen administrative, përpunimin e të dhënave, koordinimin e punës dhe realizimin paralel të fazave të ndryshme të projektimit.

Përcaktimi i periudhës prej **3 muajve të fundit të deklaruar** synon gjithashtu të provojë se ky kapacitet njerëzor është pjesë e strukturës reale dhe të qëndrueshme të operatorit ekonomik dhe nuk krijohet vetëm për efekt të pjesëmarrjes në procedurën e prokurimit.

Në këto kushte, numri minimal prej **16 punonjësish** vlerësohet **i arsyeshëm dhe proporcional me objektin, kompleksitetin dhe afatin e realizimit të kontratës**, duke krijuar siguri për Autoritetin Kontraktor se operatori ekonomik disponon kapacitetet njerëzore të nevojshme për realizimin e shërbimit me cilësi dhe brenda afateve të përcaktuara.

2.3.4

Operatorët ekonomike pjesëmarrës duhet të kenë të punësuar staf inxhinierik për ekzekutimin e objektit të prokurimit, të përfshirë në licencën e shoqërisë si drejtues teknik, të vërtetuar me kontratë pune të vlefshme, CV ku të kenë të paktën 15 vite eksperiencë, diplomë dhe të figurojnë në listpagesat e shoqërisë minimumi për 3 muajt e fundit të deklaruar nga data e hapjes së ofertave, konkretisht:

- 2 (dy) Inxhinier Ndërtimi
- 2 (dy) Inxhinier Gjeodet/Markshajder

- 1 (nje) Inxhinier Gjeolog
- 1 (nje) Inxhinier Elektrik
- 1(nje) Inxhinier Mekanik
- 2 (dy) Inxhinier Hidroteknik

Drejtuesit teknik si më sipër duhet të jenë të punësuar prane shoqërisë dhe të përmbushin kriteret sipas parashikimeve të vendimit nr.759, datë 12.11.2014 të Këshillit të Ministrave, “Për licencimin profesional të individëve dhe subjekteve juridike që do të ushtrojnë veprimtari në fushën e studimit e të projektimit në ndërtim dhe mbikqyrjes e koaludimit të punimeve të zbatimit në ndërtim”, ndryshuar me VKM-në nr.943 datë 28.12.2016”.

Shënim: Kjo kërkesë do të konsiderohet e përmbushur nëpërmjet plotësimit dhe paraqitjes nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës 10 të DST.

Dokumentacioni provues do të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar në vend të parë, pranë autoritetit kontraktor, përpara publikimit të njoftimit të fituesit paraprak dhe nisjes së afateve të ankimit.

Mbështetja ligjore: Neni 41, pika 4, i VKM nr. 285/2021, të ndryshuar; VKM nr. 759/2014, e ndryshuar me VKM nr. 943/2016; Rekomandimi APP nr. 787/2026.

Argumentimi: Ekipi kryesor është përcaktuar sipas disiplinave që prodhojnë drejtpërdrejt pjesët e projektit. Dy inxhinierët e ndërtimit nevojiten për veprat civile dhe konstruktive të veprës së marrjes, rezervuarëve dhe pusetave, si dhe për koordinimin e detajeve të zbatimit; dy gjeodetët/markshajderët për rilevimin e gjerë në pesë fshatra, ngritjen e bazës gjeodezike dhe përpunimin paralel të të dhënave; inxhinieri gjeolog për studimet e terrenit, raportin gjeologjik dhe stabilitetin; inxhinieri elektrik për komponentët elektrikë, kontrollin/instrumentimin dhe koordinimin me infrastrukturën elektrike kur këto rezultojnë të nevojshme nga zgjidhja; inxhinieri mekanik për pajisjet hidromekanike, valvulat, reduktorët dhe elementët mekanikë të sistemit; dy inxhinierët hidroteknikë për konceptimin e skemës, dimensionimin, bilancin e ujit, modelimin hidraulik dhe kontrollin e llogaritjeve. Kërkesa për përvojë të gjatë për stafin drejtues synon uljen e riskut teknik të një projekti me perspektivë 25-vjeçare dhe me vlerë të përafërt zbatimi mbi 555 milionë lekë pa TVSH, ku gabimet e projektimit mund të ndikojnë drejtpërdrejt në investimin pasues.

2.3.5 A)

A) Operatori Ekonomik ofertues duhet të ketë staf mbështetës për realizimin e këtij shërbimi punonjësit e mëposhtëm vërtetuar me a) kontratë pune të vlefshme, diplomë, CV, librezë pune , licence projektimi dhe të listuar në listpagesat e Shoqërisë për periudhën 3 muajt e fundit nga data e zhvillimit të procedurës:

Staf Ndhmës si më poshtë,

1 (nje) Inxhinier Ndërtimi

1 (nje) Inxhinier Gjeodet/Markshajder

1 (nje) Inxhinier Elektronik/Elektroteknik

-

Mbështetja ligjore: Neni 41, pika 4, i VKM nr. 285/2021, të ndryshuar; Rekomandimi APP nr. 787/2026.

Argumentimi: Stafi mbështetës kërkohet për të ndarë detyrat e prodhimit teknik nga funksionet drejtuese dhe për të mundur punë paralele brenda afatit 55-ditor. Inxhinieri i ndërtimit mbështet detajimin e veprave civile dhe vizatimeve; gjeodeti/markshajderi mbështet matjet, përpunimin e koordinatave,

profilet dhe modelin e terrenit; inxhinieri elektronik/elektroteknik mbështet komponentët e matjes, kontrollit, instrumentimit dhe koordinimin e instalimeve teknike që mund të dalin nga zgjidhja e projektit. Këto role plotësojnë, dhe nuk zëvendësojnë, përgjegjësitë e stafit kryesor.

2.3.5 B)

2.3.5 B) Operatori Ekonomik ofertues duhet të ketë staf:

- 1 (një) punonjës me certifikatë "Përgjegjës për sigurinë dhe mbrojtjen e shendetit në punë" në përputhje me klauzolat e Ligjit Nr.10237 datë 18/02/2010 "Përsigurinë dhe shëndetin në punë" dhe V.K.M Nr.312, date 05.05.2010 "Për miratimin e rregullores "Përsigurinë në kantier", shoqëruar me kontratën individuale të punës të vlefshme, Diplome/certifikate, si dhe të figurojë në listpagesat e shoqërisë për 3 muajt e fundit të deklaruar nga data e hapjes së ofertave. (Ne rastin e bashkimit të operatoreve ekonomike, grupimi duhet të ketë pjesë të stafit të tij 1 një punonjës me certifikatë "Përgjegjës për sigurinë dhe mbrojtjen e shendetit në punë")
- 2 (dy) punonjës të pajisur me certifikatë Water Cad ose program ekuivalent.
- 1 (një) punonjës specialist "Ekspert Zjarrfikës në fushën e mbrojtjes nga zjarri dhe për shpetimin" në përputhje me klauzolat Ligjit Nr. 152/2015 "Për shërbimin e mbrojtjes nga zjarri dhe për shpetimin", Neni 49, pika 4, shoqëruar me kontratë individuale pune të vlefshme, Diplome/certificate dhënë nga Drejtoria MZSH, si dhe të figurojë në listpagesat e shoqërisë minimumi për 3 muajt e fundit të deklaruar nga data e hapjes së ofertave. (Ne rastin e bashkimit të operatoreve ekonomike, grupimi duhet të ketë pjesë të stafit të tij 1 një punonjës "Ekspert Zjarrfikës në fushën e mbrojtjes nga zjarri dhe për shpetimin")
- 1 (një) punonjës me certifikatë "Ekspert për ndikimin e vlerësimit në mjedis" (VNM) të pajisur me certifikatë të lëshuar nga Ministria e Mjedisit, shoqëruar me kontratë individuale pune të vlefshme, Diplomë/certifikatë, si dhe të figurojë në listpagesat e shoqërisë minimumi për 3 muajt e fundit, të deklaruar nga data e hapjes së ofertave. (Në rastin e Bashkimit të Operatorëve ekonomikë, Grupimi duhet të ketë pjesë të stafit të tij 1 (një) specialist "Ekspert për ndikimin e vlerësimit në mjedis").

Shënim: Kjo kërkesë do të konsiderohet e përmbushur nëpërmjet plotësimit dhe paraqitjes nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës 10 të DST.

Dokumentacioni provues do të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar në vend të parë, pranë autoritetit kontraktor, përpara publikimit të njoftimit të fituesit paraprak dhe nisjes së afateve të ankimit.

Mbështetja ligjore: Neni 41, pika 4, i VKM nr. 285/2021, të ndryshuar; Ligji nr. 10237/2010 dhe VKM nr. 312/2010; Ligji nr. 152/2015; legjislacioni mjedisor në fuqi; Rekomandimi APP nr. 787/2026.

Argumentimi: Përgjegjësi i sigurisë dhe shëndetit në punë lidhet me aktivitetet në terren (vërtetim, matje topografike, inspekte, akses në trasetë dhe zonat e veprave), të cilat duhet të organizohen me masa sigurie. Dy specialistët WaterCAD ose program ekuivalent lidhen drejtpërdrejt me kërkesën e Detyrës së Projektimit për modelim hidraulik, kalibrim, analiza skenarësh, bilanc uji dhe dimensionim të rrjetit; numri dy mundëson zhvillimin dhe verifikimin paralel të modeleve për disa nënzona. Eksperti VNM është i lidhur drejtpërdrejt me produktin e kërkuar "Raport i Vlerësimit Mjedisor". Eksperti i mbrojtjes nga zjarri synon të mbulojë kërkesat e sigurisë së objekteve teknike/shërbimit dhe instalimeve që mund të kërkojnë trajtim të mbrojtjes nga zjarri në projektin e zbatimit.

2.3.6

Operatori ekonomik duhet të paraqesë certifikatat si më poshtë:

- a) Certifikatën e cilësisë së punimeve ISO 9001-2015 (e vlefshme)/ose/ekuivalent Sistemi i Menaxhimit të Cilësisë.

b) Certifikatën e cilësisë së punimeve ISO 14001-2026 (e vlefshme)/ose/ekuivalent Për sistemin e menaxhimit cilesise se Mjedisit.

c) Certifikatën e cilësisë së punimeve ISO 45001-2018 (e vlefshme)/ose/ekuivalent Për sistemin e Menaxhimit të Shendetit dhe Sigurise ne Pune.

d) Certifikatën e cilësisë së punimeve ISO 50001:2018 (e vlefshme)/ose/ekuivalent Për sistemin e Menaxhimit të Energjise.

Shënim: Në rastet e Bashkimit te Operatoreve ekonomik çdo anëtar i grupit duhet të paraqese certifikatën e mësipërme në bazë të zërave të marrë përsipër të realizoje sipas marrëveshjes së bashkëpunimit.

Mbështetja ligjore: Neni 44 i VKM nr. 285/2021, të ndryshuar; Rekomandimi APP nr. 787/2026.

Argumentimi: ISO 9001 kërkohet për të garantuar një sistem të dokumentuar të kontrollit të cilësisë në një shërbim që përfshin shumë faza, disiplina, raporte, llogaritje dhe vizatime. ISO 14001:2026 lidhet me menaxhimin e ndikimeve mjedisore, ndërkohë që Detyra kërkon VNM dhe ndërhyrja lidhet me burime ujore dhe infrastrukture lineare. ISO 45001:2018 lidhet me menaxhimin e shëndetit dhe sigurisë gjatë aktiviteteve të terrenit dhe organizimit të shërbimit. ISO 50001:2018 lidhet me objektivin e projektit për një skemë sa më eficiente energjetikisht, duke favorizuar operimin me gravitet dhe reduktimin/eliminimin e nevojës për pompim. Pranimi i certifikatave ekuivalente ruan konkurrencën dhe trajtimin e barabartë.

2.3.7

2.3.7 Operatori ekonomik duhet të paraqesë një deklaratë me shkrim mbi disponueshmërinë e mjeteve që do shërbejnë për ofrimin e shërbimit të projektimit, ku të përcaktohen të dhënat teknike dhe sasitë përkatëse për mjetet e mëposhtme:

- 2 (dy) Pajisje GPS

- 2 (dy) Total station

- 2 (dy) pajisje Droni i dizajnuar për inspektim, monitorim, detektim i pajisur me LIDAR.

Për të vërtetuar përmbushjen e këtij kriteri, duhet të paraqitet dokumentacioni i vlefshëm, si më poshtë: dokumentacion për pajisjen në pronësi, ose me qera, ose me huapërdorje (fatura blerje / dokumente zhdoganimi / kontrata qiraje / kontrata huapërdorje / kontratë dhurimi / çdo dokument tjetër me anë të të cilit fitohet e drejta e pronësisë ose përdorimit sipas Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë).

Ky Kriter konsiderohet i përmbushur me plotesimin e formularit si pas shtojcës 10 të DT. Dokumentet provuese të kërkuara më sipër, do të paraqiten nga ofertues i kualifikuar i pari, për para publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, ose nëse kërkohen sqarime nga Autoriteti Kontraktor.

Mbështetja ligjore: Neni 41, pika 4, i VKM nr. 285/2021, të ndryshuar; Rekomandimi APP nr. 787/2026.

Argumentimi: Pajisjet lidhen drejtpërdrejt me shërbimet e rilevimit të parashikuara në Detyrën e Projektimit: identifikim dhe matje të pikave fikse, ngritje të rrjetit gjeodezik, rilevim topografik të zonës, planimetri dhe profile të linjave, studime morfologjike tokësore/ajrore dhe model dixhital të terrenit. Dy GPS dhe dy total station mundësojnë dy ekiye matjeje që punojnë paralelisht në pesë fshatra dhe në trasetë e linjave, në përputhje me afatin 55-ditor, si dhe krijojnë mundësi kontrolli/kryqëzimi të matjeve. Dronët me LIDAR ose ekuivalente synojnë mbledhjen e shpejtë të të dhënave tridimensionale dhe prodhimin e modelit dixhital të terrenit për zonat e studimit, duke plotësuar matjet tokësore.

2.3.8

2.3.8 Operatori ekonomik duhet të paraqesë një CV te shoqërise per punet e realizuara gjate aktivitetit te saj.

Në cdo rast AK ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik ose ti kërkojë operatorit ekonomik sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime.

Operatori ekonomik ofertues në përllogaritjen e ofertës duhet ti referohet njoftimit të bërë me Nr. 5585 Prot. datë 25.07.2017 të Agjensisë së Prokurimit Publik "Rekomandim mbi mënyrën e përcaktimit të tarifave minimale të specifikuara në Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr.354 datë 11.05.2016 "Për miratimin e manualit të tarifave për shërbime në planifikim territori, projektim, mbikëqyrje dhe kolaudim".

Mospërgatitja e ofertës sipas bazës ligjore të sipërpërmendur përbën shkak për skualifikim pasi ajo duhet të jetë brenda kufijve të vlerës minimale dhe maksimale të lejuar në kuptim të nenit 7/1 të VKM nr 354, datë 11.05.2016 "Për miratimin e manualit të tarifave për shërbime në planifikimin të territorit, projektim, mbikëqyrje dhe kolaudim" i azhornuar.

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara.

Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.

Mbështetja ligjore: VKM nr. 354, datë 11.05.2016, e azhornuar; Njoftimi/Rekomandimi APP nr. 5585 Prot., datë 25.07.2017; Ligji nr. 162/2020, i ndryshuar; VKM nr. 285/2021, e ndryshuar.

Argumentimi: CV-ja e shoqërisë jep një pasqyrë të organizimit dhe portofolit profesional, ndërsa prova juridike e përvojës së ngjashme mbetet ajo e kërkuar në pikën 2.3.1. Referenca te VKM nr. 354/2016 dhe rekomandimi i APP nr. 5585 Prot., datë 25.07.2017 synon që oferta financiare për shërbimin e projektimit të ndërtohet mbi metodologjinë dhe kufijtë tariforë të zbatueshëm për shërbimet e planifikimit/projektimit, duke shmangur oferta që nuk respektojnë bazën normative të llogaritjes së tarifës.

E drejta e AK për verifikim lidhet me detyrimin për vërtetësinë e deklarimeve dhe dokumenteve të kualifikimit.

II. ARGUMENTIMI DHE MIRATIMI I SPECIFIKIMEVE TEKNIKE / TERMAVE TË REFERENCËS

Shtojca 6 – FORMULARI I SPECIFIKIMEVE TEKNIKE

Detyra e Projektimit bashkangjitur ne SPE

Mbështetja ligjore: Neni 41, pika 1, dhe neni 78, pika 2, i VKM nr. 285/2021, të ndryshuar; Rekomandimi APP nr. 3872/2021 dhe nr. 787/2026.

Argumentimi: Specifikimet teknike janë hartuar në formën e Detyrës së Projektimit, pasi objekti është shërbim intelektual projektimi dhe produkti përfundimtar përcaktohet nga kërkesat funksionale, standardet, studimet dhe fazat e projektimit. Detyra përcakton qartë objektin, vendndodhjen, qëllimin, gjendjen ekzistuese, parametrat e projektimit, rezultatet e pritshme, fazat e punës, raportet/studimet, vizatimet, llogaritjet dhe mënyrën e dorëzimit. Kjo formë i jep operatorëve të njëjtin informacion bazë për përgatitjen e metodologjisë dhe ofertës dhe krijon kritere të verifikueshme për pranimin e produktit.

1. Gjendja ekzistuese dhe nevoja për ndërhyrje

Argumentimi: Në Detyrën e Projektimit evidentohet se rrjetet në disa prej fshatrave janë të degraduara dhe shumë të amortizuara, ndërsa në zona të tjera infrastruktura është e pamjaftueshme; janë kryer ndërhyrje fragmentare dhe kërkohet zgjidhje e plotë. Për rrjedhojë, specifikimi që kërkon studim të gjendjes ekzistuese, verifikim në terren dhe hartim të një skeme të re/rehabilituar është i domosdoshëm për të shmangur projektim mbi të dhëna të paplota.

2. Vepra e marrjes, linjat, depot, rrjeti dhe matja

Argumentimi: Kërkesa për projektimin e veprës së marrjes, linjës kryesore të furnizimit, depove të çdo fshati, rrjeteve të jashtme/shpërndarëse, puseta të komandimit/reduktimit/ajrimit dhe matësve lidhet drejtpërdrejt me objektivin për një sistem të integruar furnizimi me ujë dhe me eliminimin e ndërhyrjeve fragmentare.

3. Furnizimi 24 orë dhe perspektiva 25-vjeçare

Argumentimi: Parametrat e furnizimit 24 orë/ditë, presioni minimal/maksimal dhe horizonti 25-vjeçar janë kriteret funksionale të performancës së sistemit. Ato shërbejnë për dimensionimin e burimit, depove, linjave dhe rrjetit dhe për verifikimin e skemës në skenarë të ndryshëm kërkesë.

4. Studimet topografike, gjeologjike, hidrologjike dhe hidrogeologjike

Argumentimi: Këto studime janë të nevojshme për pozicionimin e saktë të veprave, profilet e tubacioneve, kuotat, stabilitetin e terrenit, vlerësimin e burimeve dhe kushtet e ndërtimit. Pa këto të dhëna nuk mund të hartohen në mënyrë të sigurt llogaritjet hidraulike, konstruktive dhe projekti i zbatimit.

5. Modelimi dhe llogaritjet hidraulike

Argumentimi: Detyra kërkon bilanc uji, modelim hidraulik, kalibrim dhe analiza skenarësh. Kjo është thelbësore për zgjedhjen e diametrave, kontrollin e presioneve, volumet e depove, funksionimin me gravitet dhe verifikimin e furnizimit në të pesë fshatrat.

6. Projekt-ide në variante dhe zgjedhja e alternativës

Argumentimi: Kërkesa për jo më pak se dy variante në fazën paraprake siguron krahasimin teknik dhe ekonomik të zgjidhjeve, përzgjedhjen e skemës më të realizueshme dhe dokumentimin e vendimmarrjes përpara se të zhvillohet projekti përfundimtar.

7. Raporti i Vlerësimit Mjedisor dhe standardet

Argumentimi: Raporti VNM dhe respektimi i standardeve kombëtare, si dhe përdorimi i praktikave të mira/standardeve të BE-së kur janë të aplikueshme, janë të lidhura me mbrojtjen e burimeve ujore, ndikimet e infrastrukturës lineare dhe cilësinë e produktit të projektimit.

8. Projekti i zbatimit, specifikimet teknike dhe preventivi

Argumentimi: Vizatimet e detajuara, relacionet, llogaritjet, specifikimet teknike, preventivi dhe analizat e çmimeve janë dokumentet bazë për fazën pasuese të prokurimit dhe zbatimit të punimeve. Kërkesa për këto produkte siguron që studim-projektimi të jetë i plotë dhe i përdorshëm për realizimin e investimit.

9. Afati dhe organizimi i dorëzimeve

Argumentimi: Detyra parashikon 55 ditë të ndara sipas fazave të projektimit. Ndarja në faza lejon kontrollin e ndërmjetëm të rezultateve, korrigjimin e zgjidhjeve përpara projektit final dhe koordinimin e punës së ekipeve multidisiplinare.

10. Formati i dorëzimit

Argumentimi: Kërkesa për kopje të printuara A3/A4 dhe dorëzim dixhital të materialeve të punuara dhe PDF siguron arkivim, kontroll, përdorim institucional dhe mundësi për vijimin e procedurave të financimit/prokurimit të punimeve.

Përfundim specifikimet dhe termat e referencës, të materializuara në Detyrën e Projektimit, konsiderohen të lidhura me objektin e kontratës dhe të nevojshme për prodhimin e një projekti të zbatueshëm. Ato duhet të publikohen në SPE në të njëjtën përmbajtje me versionin e miratuar dhe të shoqërohen me këtë procesverbal.

Pas shqyrtimit të lidhjes së kërkesave me objektin, volumin, kompleksitetin dhe afatin e shërbimit, specifikimet teknike/termat e referencës dhe kriteret e veçanta të kualifikimit miratohen në parim si më sipër, me kusht që vërejtjet e shënuara për harmonizim të reflektohen në versionin përfundimtar të DST-së përpara publikimit. Versioni i publikuar në SPE duhet të jetë identik me versionin e miratuar dhe me këtë procesverbal.

NJËSISIA E PROKURIMIT